



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 58

Tiranë – E enjte, 16 prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 287, datë 1.4.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.. 2567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 8.4.2015	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit 2015-2017, “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike”.. 2569
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 8.4.2015	Për përcaktimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit të armëve..... 2573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 293, datë 8.4.2015	Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit..... 2574
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 8.4.2015	Për krijimin e Këshillit të Investimeve..... 2576
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 8.4.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 31, datë 22.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”..... 2578
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 8.4.2015	Për përcaktimin e masës së financimit nga buxheti i vitit 2015 për bashkësitë fetare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 2578
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 8.4.2015	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit e formimit profesional dhe të sekretariatit teknik..... 2579
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 298, datë 8.4.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 2581

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 8.4.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”.....	2583
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 8.4.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv, Vau i Dejës-Morinë.....	2584
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 8.4.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, lotet 6-11 (objekte dhe toka)”	2586
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 8.4.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit “Nyja rrugore Vorë”.....	2590



VENDIM

Nr. 287, datë 1.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të hiqen pronat me numrat rendorë 13, 17, 21 e 22 dhe të dhënat të jepen, sipas formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
6			Truall + Nderetese	Arkivi Shtetëror Vendor i Qarkut DISE/II Rruga N. Ruzhiti	1045	565	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine dy kateshe
7			Truall + Nderetese	Dega Arkivore MAT	474	234	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me policine financiare Ne kal te pare e te dyte
8			Truall + Nderetese	Arkivi Shtetëror Vendor i Qarkut ELBASAN Ne qender	810	270	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine kater kateshe
9			Truall + Nderetese	Arkivi Shtetëror Vendor i Qarkut SHKODER Rruga e fermentimit	2010,2	481,2	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine dy kateshe
10			Nderetese	Dega Arkivore LIBRAZHID Ne qender	144	144	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me Bashkine Ne katin e pare e te trete
11			Nderetese	Arkivi Shtetëror Vendor i Qarkut KUKES Ne qender	320	320	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me Prokurorine Ne katin e trete
12			Nderetese	Dega Arkivore TROPOJE Ne qender	100	100	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me Bashkine Ne katin e trete
13			Truall + Nderetese	Arkivi Shtetëror Vendor i Qarkut KORCE			Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Ish fabrika e roketave e porjeve



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
				Vend Ruajtje te D.P.A						
14			Truall + Ndertese	POGRADEC Ne gender	200	165	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine tri kateshe
15			Ndertese	Dega Arkivore KOLONJE Ne hyrje te qytetit Enxhe	271	271	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine dy kateshe. Ish magazinat e tregtise
16			Ndertese	Dega Arkivore TEPELENE Ish magazina,afar rep.Ushtrarak	1000	1000	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine dy kateshe
17			Ndertese	Dega Arkivore PERMET Tek guri i Qytetit	240	240	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me D.BU Ne katin e pare e te dyte
18			Ndertese	Arkivi Shtetror Vendor i Qarkut VLORE Tuneli nen Guzbaba	520	520	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Ndodhet ne tunel
19			Truall + Ndertese	Arkivi Shtetror Vendor i Qarkut VLORE Ne gender	730	430	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine nje kateshe ish vend komand ne kohe te vecante
20			Truall + Ndertese	Arkivi Shtetror Vendor i Qarkut BERAT Ne hyrje te qytetit	2496	1152	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine tek rezervat e shtetit
21			Ndertese	Dega Arkivore SKRAPAR Ne gender			Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me Bashkine Ne katin e pare
22			Ndertese	Dega Arkivore PUKE Ne gender	362	362	Arkiv	D.P.A.	D.P.A.	Godine e perbashket me Bashkine Ne katin e njte
23			Truall+Ndertese	Dega Arkivore GRAMSH	810	310	Arkiv	DPA	DPA	Godine dy kateshe



**VENDIM****Nr. 291, datë 8.4.2015**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT
KOMBËTAR TË VEPRIMIT 2015-2017,
“PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR TRAFIKIMIT TË MJETEVE
MOTORIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2015-2017, “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Infra-strukturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

PLAN KOMBËTAR VEPRIMI, 2015 - 2017**“Për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Mjeteve Motorike”**

Krimi ndaj automjeteve është një formë e krimit që lidhet qartë me krimin e organizuar. Vjedhja e automjeteve jo vetëm që ju heq të drejtën e pronës pronarëve të tyre, por edhe ndihmon trafikimin e tyre për të financuar krime të tjera, si grabitjen, pengmarrjen, trafikimin e personave, transportimin e sendeve të vjedhura, korrupsionin dhe trafikimin e vetë automjeteve.

Në këto rrethana e në shprehje të vullnetit për të luftuar veprimtarinë kriminale ndaj automjeteve dhe Trafikimin e Mjeteve Motorike të Vjedhura, Kontrabanduara dhe me Shkelje të tjera Ligjore, Policia e Shtetit ndërmori iniciativën për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Trafikimit të Mjeteve Motorike të Vjedhura”. Ky dokument u hartua me kontributin e institucioneve kombëtare përgjegjëse që merren me luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike si - Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me strukturat e saj: Sektori Kundër Trafikeve të Paligjshme, ZQK Interpol Tirana, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti për Sigurinë Publike, Drejtoria Kundër Krimit Financiar, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit), - Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, - Ministria e Financave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; dhe - Prokuroria e Përgjithshme.

Qëllimi i Planit Kombëtar të Veprimit është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, zhvillimi e aplikimi i metodave të reja ligjore dhe institucionale në përshtatje me specifikën në vendin tonë të fenomenit të trafikimit të mjeteve motorike të vjedhura, si dhe zhvillimi i mënyrave dhe metodave më efektive nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike.

Në këtë Plan Veprimi, synohet të arrihet koordinimi për :

- veprime specifike të institucioneve kombëtare përgjegjëse në procesin e trajtimit të makinave si: regjistrim, zhdoganim, verifikim, identifikim, etj.
- shkëmbimin e shpejtë të informacioneve
- krijimin e lidhjeve direkte (online) për verifikime të shpejta,
- plotësimin dhe përfundimin e hetimeve të suksesshme ndaj fenomenit të trafikimit të automjeteve
- forcimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe
- rritjen e ndërgjegjësimit e publikut në lidhje me këtë fenomen.

Nga analiza e kryer “Planit Kombëtar të veprimit 2012-2014, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikimit të mjeteve motorike të vjedhura, kontrabanduara dhe me shkelje të tjera ligjore”, u konkludua se ka patur arritje në fushat e mëposhtme:

- Aksesit në përdorimin e bazës së të dhënave EASF2 të INTERPOL-it nga:
 - strukturat kundër trafikeve të paligjshme në qendër dhe bazë
 - të gjitha pikat e kalimit kufitar
 - autoritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor
- integrimi i bazës së të dhënave EASF2 të INTERPOL-it në Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) në Policinë e Shtetit,



- Kryerja e disa operacioneve të përbashkëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për trafikimin e automjeteve të vjedhura;
- shkëmbim informacioni në kohë reale ndërmjet strukturave të angazhuara në këtë Plan Veprimi çka ka sjellë efikasitet në luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike.

Megjithë rezultatet pozitive të arritura deri tani në këtë fushë ende ka sfida të tjera me të cilat duhet të përballemi si:

1. Parandalimi i trafikimit të automjeteve të vjedhura.
2. Identifikimi i automjeteve të trafikuar, nëpërmjet përmirësimit të procedurave të gjetjes së automjeteve të vjedhura dhe bashkëpunimit me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit;
3. Identifikimi i personave të përfshirë në aktivitetin kriminal të trafikimit të automjeteve, përfshirja e tyre në procese ligjore hetimi, përfundimi i hetimeve, dënimi i tyre dhe kthimi i automjeteve të vjedhura pronarëve të ligjshëm;
4. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike;

Nisur nga rezultatet, përvoja e problemet e evidentuara deri tani dhe sfidat e tjera me të cilat duhet të përballemi deri në 2017, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kombëtare përgjegjëse dhe njëkohësisht adoptimin e mjeteve dhe metodave ligjore më efikase nga të gjitha këto institucione në luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike, në Planin Kombëtar të Veprimit janë parashikuar këto aktivitete:

I. Krijimi i një baze të dhënash në TIMS, për automjetet e vjedhura në vendin tonë, shpallja e tyre në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Hartimi i një urdhri të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për shpalljen në kërkim dhe heqjen nga kërkimi ndërkombëtar të automjeteve të vjedhura, dhe përcaktimin e tabelës me kriteret që kërkohen për shpalljen në kërkim ndërkombëtar të automjeteve të vjedhura.	Policia Shtetit	Në vijim	Evidentimi i të gjitha automjeteve të vjedhura në territorin shqiptar në sistemin TIMS dhe hedhja e këtyre të dhënave në bazën e të dhënave të INTERPOLIT.	Ekzistuese
2. Grumbullimi i të dhënave mbi mjetet e vjedhura. a. strukturat policore përkatëse në qarqe dërgojnë informacionet mbi mjetet e vjedhura dhe të dhënat e tyre në përputhje me aktet në fuqi, në Drejtorinë për Krimet. b. Drejtoria për Krimet në Departamentin për Sigurinë Publike në Policinë e Shtetit pas grumbullimit e verifikimit të këtyre të dhënave krijon një bazë të dhënash për menaxhimin sa më efikas të këtyre informacioneve.	Departamenti për Sigurinë Publike, Drejtoria e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, Sektori i kartotekës, ZQK Interpol Tirana,			
3. Menaxhimi i të dhënave të automjeteve të vjedhura. a. Dërgimi i informacionit për mjetet e vjedhura Sektorit të Kartotekës në D.P.Policisë, për kryerjen e procedurave për shpalljen në kërkim të mjeteve të vjedhura. b. Një kopje e tij i dërgohet Drejtorisë së T.I-së, me qëllim regjistrimin e tyre në TIMS. c. Rifreskimi në vazhdimësi i bazës së të dhënave mbi mjetet e vjedhura me ndryshimet e ndodhura.	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit	2015		
4. Përdorimi i të dhënave. a. Përdorimi i të dhënave të mjeteve të vjedhura për verifikim në Sistemin TIMS nga përdoruesit në bazë të aksesit.	D.P.SH.T.RR			

II. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet D.P.SH.T.RR-së dhe D.P.P.SH-së

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor i përfundimit	Tregues	Burimet
Shkëmbimi i informacionit do të bëhet nga Policia e Shtetit për: • Mjetet që hyjnë në territorin shqiptar. • Mjetet motorike të vjedhura të regjistruara në Sistemin EASF2 të Interpolit. • Mjetet motorike të sekuestruara dhe të kaluara në rezervat e shtetit. • Mjetet motorike të bllokuara.	Policia Shtetit (DTI)	Në vazhdim	Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera ligjzbatuese të verifikojnë drejtpërdrejt targimin e mjeteve motorike në sistemin përkatës, duke krijuar një sistem të mbyllur unik	Ekzistuese



• Denoncimet për humbje të dokumentave dhe targave. • Mjetet motorike të trafikuar në vendin tonë. D.P.S.H.T.RR-ja për : • Mjete motorike të regjistruara për herë të parë në Republikën e Shqipërisë dhe mjetet pronarët e të cilëve kryejnë ndërrimin e pronësisë, ndryshimin e targave, paisjes me certifikatë pronësie etj., të cilat dalin pozitive në sistemin EASF2 të Interpolit; • Të dhëna të tjera në lidhje me mjetet motorike dhe pronarët e tyre. • Të dhëna për drejtuesit e mjeteve motorike.	D.P.S.H.T.RR (DTI)		gjithëpërfshirës.	
---	-----------------------	--	-------------------	--

III. Përdorimi i Sistemit TIMS nga Shërbimi doganor, me qëllim monitorimin për mbylljen e regjimit të përkohshëm të mjeteve me targa të huaja

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
Përditësimi dhe mirëmbajtja e përdorimit të sistemit TIMS të Shërbimit Doganor për një kontroll më të mirë dhe efektiv të hyrje/daljeve të automjeteve me R.P.L. në bashkëpunim me Policinë Kufitare.	D.P.D P.SH	Në vazhdim	Kontrolli më të mirë dhe efektiv të hyrje/ daljeve të automjeteve me R.P.L. nga dogana dhe Policia Kufitare.	Ekzistuese

IV. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet shërbimeve doganore dhe policisë rrugore, për mjete që kanë shkelur rregullat e lejimit të përkohshëm të qarkullimit të mjeteve me targa të huaja

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor i përfundimit	Tregues	Burimet
Marrja e masave organizative për kontrolle ndaj mjeteve me targa të huaja me regjim të përkohshëm qarkullimi dhe penalizimet përkatëse.	D.P.D P.SH Policia rrugore	Në vijim	Shoqërimi dhe ndëshkimi ligjor i personave që përdorin mjete me targa të huaja në vendin tonë, në kundërshtim me dispozitat ligjore.	Ekzistuese

V. Dhënia e së të drejtës së përdorimit, në Sistemin ASF2 të Interpolit, organit të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative pranë Njësi Rajonale të Policisë Rrugore

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
Verifikimi në sistemin EASF2 të Interpolit, për të gjitha mjetet që i nënshtrohen gjykimit administrativ, nëse rezultojnë të vjedhura/trafikuar dhe raporti i përftuar të jetë pjesë e praktikës administrative për çdo rast. Në rastet kur nga kontrolli në sistemin EASF2 të Interpolit rezultojnë mjete të vjedhura/trafikuar, Organi Shtetëror i Gjykimit të Kundravajtjeve Administrative pranë Njësi Rajonale të Policisë Rrugore, të njoftojë me shkrim strukturat për Trafiket e Paligjshme sipas juridiksionit, për nisjen e hetimeve të nevojshme. Për rastet kur nga verifikimi dalin të dhëna se një automjet është i vjedhur apo trafikuar, shërbimi i policisë gjyqësore me iniciativë dhe pa vonesë kryhen veprimet hetimore të	P.SH Departamenti për S.Publike ZQK Interpol Tirana DTI	Në vazhdim	Shoqërimi i mjetit në ambientet e policisë për verifikim dhe sekuestrim kur rezultojnë “pozitiv” në sistemin ASF2 të Interpolit. Sekuestrimi i mjeteve të vjedhura/trafikuar dhe fillimi i hetimeve për autorët e kësaj veprimtarie kriminale.	Ekzistuese



nevojshme, duke bërë menjëherë referimin e veprës penale tek prokurori në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (neni 293 e vijues i KPP), sipas juridiksionit ku është gjetur mjeti.			
---	--	--	--

VI. Regjistrimi në Sistemin TIMS i numrave të shasisë të mjeteve gjatë hyrje/daljeve për disa raste të veçanta

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor i përfundimit	Tregues	Burimet
Regjistrimi i numrave të shasisë së mjeteve për rastet: - Kur në P.K.K-të nuk ka fluks të mjeteve në kufi; - Kur mjetet hyjnë për herë të parë në kufi; - Kur vitprodhimi i mjeteve i përket viteve të fundit; - Kur mjetet janë luksoze; - Kur mjetet kalojnë për kontroll në vijën e dytë dhe; - Për mjetet e delegacioneve zyrtare që dalin nga Republika e Shqipërisë.	P.SH (DK & M)	Në vazhdim	Rritja e mundësisë së identifikimit të mjeteve të trafikuar në vendin tonë.	Ekzistuese

VII. Përmirësimi i teknologjisë për monitorimin e P.K.K-ve

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor i përfundimit	Tregues	Burimet
Vendosja e sistemit të kamerave dhe lexuesve automatik të numrave të shasisë së automjeteve me qëllim përdorimin e imazheve nga shërbimi doganor dhe policia kufitare, për mjetet që hyjnë e dalin në këto vendkalime.	D.P.D (DTI) P.SH (DTI)	Në vazhdim	Rritja e bashkëpunimit mes policisë kufitare dhe shërbimit doganor, për goditjen e aktiviteteve të kundraligjshme që lidhen me mjetet motorike.	Donatorë

VIII. Publikimi i listës së mjeteve të vjedhura

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor i përfundimit	Tregues	Burimet
Në faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme të krijohet një rubrikë ku të jetë i mundur konsultimi i publikut me bazën e të dhënave të mjeteve të vjedhura (numër shasie dhe targë), si pjesë e informacionit që policia jep për publikun.	P.SH (DTI)	2015	Informimi i publikut në lidhje me automjetet e vjedhura në vendin tonë.	Ekzistuese

IX. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike.

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjëse	Afati kohor i përfundimit	Tregues	Burimet
Hartimi i procedurave standarte të Veprimit (PSV) për rolin dhe detyrat e njësisë policore dhe agjencive të tjera në operacione të përbashkëta për krimin ndaj automjeteve. Trajnime për metodologjinë që ndiqet në pikat e kontrollit në rastet e operacioneve të përbashkëta kombëtare e ndërkombëtare.	P.SH Sektori për Trafikë e Paligjshme	2016 Pas përfundimit të PSV	Informimi i publikut në lidhje me automjetet e vjedhura në vendin tonë.	Donatorë

FJALORI I SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

D.P.D.	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
D.P.SH.T.RR.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
P.SH.	Policia e Shtetit
DTI	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
DSP	Departamenti për Sigurinë Publike
DKM	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
ZQK	Zyra Qëndrore Kombëtare
DQPM	Drejtoria e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave
PSV	Procedurat Standarte të Veprimit
TIMS	Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit

**VENDIM****Nr. 292, datë 8.4.2015****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN
E REGJISTRIT TË ARMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, në Policinë e Shtetit, të regjistrit të armëve në pronësi të personave fizikë e juridikë, i cili mbahet në organin përgjegjës të policisë vendore.

2. Regjistri i armëve krijohet mbi bazën e të dhënave të armëve në pronësi të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

3. Regjistri i armëve mbahet në dy forma:

- a) në formën e shkruar;
- b) në formën elektronike.

4. Regjistri në formën e shkruar dhe ai në formën elektronike kanë të njëjtin format standard, të miratuar me këtë vendim. Elementet e veçanta që karakterizojnë regjistrin elektronik nuk përbëjnë shmangie nga forma standarde e regjistrit dhe lidhen vetëm me paraqitjen

elektronike të të dhënave. Për plotësimin e regjistrit të shkruar dhe atij elektronik zbatohen të njëjtat rregulla.

5. Regjistri i armëve përmban të dhëna për:

- a) identitetin e personit që ka armën në pronësi;
- b) armën;
- c) licencën, autorizimin dhe vendimin për pajisjen me armë;
- ç) dokumentet e pajisjes dhe heqjes së armës.

6. Format standard i regjistrit të armëve, i krijuar për armët në pronësi të personave fizikë e juridikë, është sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Të dhënat që administrohen në regjistrin e armëve u vihen në dispozicion, sa herë që kërkohen, organeve të drejtësisë, në përputhje me qëllimin e përpunimit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Regjistrat e armëve mbahen nga organet përgjegjëse të policisë vendore, me afat ruajtjeje të përhershëm.

9. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Drejtorja e Përgjithshme e Policisë Shtetit
Njësia Shpenzuese _____

REGJISTRI I ARMËVE

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Datëlindja	Vendbanimi			Arma e Furnizuar		Lloji i autorizimit për mbajtje të armës	Numri i Autorizimit	Vendimi		Dokumenti marrjes së Armës		Nënshkrimi për marrjen e armës në ngarkim	Dokumenti i heqjes së armës		Vërejtje
			Fshati	Qyteti (lagje)	Telefon	Emërtimi kalibri tipi marka	Germa dhe numri			Nr	Data	Nr	Data		Nr	Data	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	
13																	
14																	
15																	
16																	
17																	
18																	
19																	
20																	

VENDIM

Nr. 293, datë 8.4.2015

**PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË
ARMATIMIT, TË LËNDËVE
NEUROPARALIZUESE DHE TË
MJETEVE TË TJERA TË PËRDORIMIT
TË FORCËS NGA POLICIA E SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 99, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit, lëndëve neuroparalizuese dhe mjeteve të tjera të

përdorimit të forcës nga strukturat e Policisë së Shtetit, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tabela organike e pajisjes me armatim, lëndë neuroparalizuese dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës miratohet me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, me propozimin e drejtorit të Policisë së Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



Lidhja

Llojet e armatimit, municionit, lëndëve neuromuskuaruese dhe mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit

Strukturat e Policisë së Shtetit në funksion të zgjidhjes së detyrave, pajisen me armatim, municion, lëndë neuromuskuaruese dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës, sipas kësaj lidhje:

1. Armatim:

1.1. Armë zjarri të shkurtra:

- a) Pistoletë 9x19 mm.

1.2. Armë të gjata:

- a) Pushkë gjysmë automatike kalibër 5.56 mm deri 9x19 mm.
- b) Automatik kalibër 5.56 x 45 mm NATO deri 9x19 mm;
- c) Pushkë me përpikëri të lartë gjysmë automatike kalibër 5.56x45 mm deri tek 12.7x 99 mm;
- ç) Shotgun kalibër 12 Ga;
- d) Shotgun lëshues kalibër 37/38x40 Ga;
- dh) Armë me veprim elektromuskular;
- e) Armë antitanke një përdorimshe.
- ë) Armë të ftohta

2. Municion:

- a) Municione për armët e shkurtra e të gjata sipas kalibrave përkatës me të gjitha llojet e cilësisë së veprimit;
- b) Municione me lëndë irrituese në formë pluhuri, lëngu me përbërje CS; CN; OC; që hidhen me shotgun, me granatë dore, pajisje hedhëse, sprajt ose tubet, për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e turmave;
- c) Municione që hidhen me shotgun me saçme: gome, metalike, sintetike;
- ç) Granata akustike dhe verbuese;
- d) Lëndë plasëse për shpërthim dyersh.

3. Pajisjet e mbrojtjes dhe përdorimit të forcës personale e kolektive:

- a) Jelek antiplumb niveli i III, IIIA, IV;
- b) Kaska antiplumb me pajisje komunikimi dhe pa pajisje komunikimi;
- c) Mburoja individuale, kolektive antiplumb;
- ç) Kaska balistike antiplumb;
- d) Kostum për mbrojtje nga mjetet e forta;
- dh) Mburoja "Policia";
- e) Kaska "Policia";
- ë) Shkop gome/metalik
- f) Pranga;
- g) Maska gazi;
- gj) Mjete optike (kamera, dylbi për ditë dhe natë);
- h) Pajisje kërkimi (metalkërkues, minakërkues, detektor);
- i) Bllokues rruge;
- j) Syze balistike;
- k) Mjete ndriçuese.

**VENDIM****Nr. 294, datë 8.4.2015****PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË
INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes, mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar në 24 shkurt 2014, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit të Investimeve (KI) si një organ këshillimor, i specializuar e ndërmjetës, për lehtësimin e dialogut midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e donatorëve dhe qeverisë, për zhvillimin e një mjedisi biznesi/investimesh të favorshëm, jodiskriminues dhe transparent.

2. Objekti i veprimtarisë së Këshillit të Investimeve është nxitja e dialogut konstruktiv dhe shkëmbimi i pikëpamjeve midis qeverisë dhe sektorit privat, në drejtim të:

a) zhvillimit të sektorit privat, përmirësimit të klimës së biznesit dhe rritjes së investimeve, me financim të huaj apo të brendshëm;

b) identifikimit të pengesave kryesore të biznesit, në sektorë të caktuar të ekonomisë, dhe formulimit të strategjive të ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative;

c) identifikimit të pengesave kryesore të investimeve dhe krijimit të një platforme objektivash, iniciativash e mekanizmash të nevojshëm për të tërhequr sa më shumë investime, si të huaja edhe të brendshme;

ç) adaptimit të metodave që lehtësojnë aksesin në financë, për bizneset e reja dhe ato ekzistuese;

d) rishikimit dhe vlerësimit të draftakteve ligjore, me ndikim të biznesit, duke propozuar ndryshime të nevojshme të kuadrit rregullator ekzistues, që lidhen me pengesat për fillimin, operimin, rritjen apo mbylljen e një biznesi;

dh) rishikimit, analizave e raportimit për rastet e trajtimit jo të barabartë e abuziv të praktikave ndaj biznesit dhe për lehtësimin e procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;

e) hartimit të praktikave më të mira në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit, për çështje që lidhen me sektorin privat, duke mbështetur Strategjinë Kombëtare të Luftës Kundër Korrupsionit;

ë) nxitjes dhe shkëmbimit të eksperiencave e praktikave më të mira nga vendet e tjera, në procesin e zbatimit të reformës rregullatore.

3. Këshilli i Investimeve, përmes kryetarit të tij dhe sipas detyrave të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, do të adresojë propozime konkrete të Kryeministrit, si dhe rekomandime për ministritë e linjës, për të iniciuar akte normative.

4. Këshilli i Investimeve do të propozojë platforma bashkëpunimi me sektorin privat dhe ministritë e linjës për priorizimin e politikave në fushën ekonomike.

5. Këshilli i Investimeve kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga qeveria, sektori privat dhe komuniteti i donatorëve, si më poshtë:

a) Anëtarë me status të përhershëm:

- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;

- Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;

- AIDA;

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;

- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

- Banka e Shqipërisë.

b) Anëtarë me status të përhershëm nga institucionet financiare ndërkombëtare:

- BERZH-i;

- BE-ja;

- BB/IFC-ja.

c) Anëtarë me status jo të përhershëm:

- tri kompani;

- tri shoqata biznesi.

Pjesëmarrja e anëtarëve me status jo të përhershëm do të caktohet nga sekretariati.

6. Këshilli i Investimeve, nëpërmjet sekretariatit, mund të kërkojë pjesëmarrjen edhe të entiteteve të tjera, si institucione ose kompani publike, apo përfaqësues të shoqërisë civile, në përputhje me agjendën dhe çështjet që do të diskutohen.

7. Anëtarët e përhershëm, si edhe anëtarët e tjerë marrin pjesë në mbledhje pa pagesë.

8. Në çdo rast vendimmarrjeje, Këshilli ushtron funksionet e tij me anë të konsensusit.



Vendimet merren edhe nga shumica, nëse konsensusi midis anëtarëve nuk arrihet. Vota e kryetarit është vendimtare në një situatë kur asnjë nga palët nuk mund të krijojë shumicën.

9. Për organizimin e aktivitetit të Këshillit të Investimeve krijohet Sekretariati i Këshillit të Investimeve, i cili financohet nga BERZH-i dhe donatorë të tjerë.

10. Numri i punonjësve të sekretariatit do të caktohet nga BERZH-i.

11. Staf i sekretariatit rekrutohet me procedurë transparente dhe konkurruese, nga ana e BERZH-it, duke respektuar standardet profesionale të punës.

12. Sekretariati mundëson, sa herë të paraqitet nevoja, ekspertizë për çështje ligjore, financiare, si dhe për çështje të kuadrit ligjor në fushën e investimeve.

13. Sekretariati mban raporte direkte me shoqatat e biznesit, donatorët dhe atashetë tregtarë të ambasadave të huaja.

14. Sekretariati i Këshillit të Investimeve kryen këto funksione:

- Harton dhe propozon agjendën për mbledhjet e Këshillit të Investimeve, bazuar në propozimet e anëtarëve të Këshillit të Investimeve;

- Organizon mbledhjet e Këshillit të Investimeve dhe fton anëtarët jo të përhershëm në mbledhjet e tij, sipas nevojave të Këshillit;

- Njofton, 10 ditë përpara, anëtarët dhe të ftuarit e Këshillit të Investimeve për datën dhe agjendën e mbledhjes dhe për materialet që do të shqyrtohen në këtë mbledhje;

- Koordinon aktivitetin e Këshillit të Investimeve me atë të ministrive të linjës, konsultimet me komunitetin e biznesit, lidhur me propozimet e tyre, që do të jenë objekt konsultimi në Këshillin e Investimeve, si dhe organizon seksionet e trajnimeve teknike;

- Asiston Këshillin e Investimeve në diskutime dhe rishikime të rasteve specifike sektoriale, të procedurave ligjore e administrative, që janë sjellë në sekretariat, bazuar në ankesa specifike nga bizneset për praktika jo të besueshme dhe diskriminuese;

- Organizon kërkime dhe analiza ekonomike, sipas fushës së veprimtarisë së Këshillit të Investimeve, dhe raporton rezultatet në Këshillin e Investimeve;

- Përgatit agjendën e detajuar, me raportet dhe minutazhin përkatës, të diskutimeve të Këshillit të Investimeve;

- Mbështet dhe monitoron procesin e zbatimit të propozimeve të Këshillit të Investimeve, vlerëson rezultatet dhe impaktin në efektivitetin e klimës së investimeve;

- Raporton, tek anëtarët e Këshillit të Investimeve, si edhe te palët e tjera të interesuara, në lidhje me progresin e arritur;

- Informon publikun në lidhje me aktivitetin e Këshillit të Investimeve;

- Harton rregulloren e brendshme të funksionimit të Këshillit të Investimeve.

15. Agjenda e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve hartohet në mënyrë periodike, sipas propozimeve të sektorit privat dhe mbi bazën e prioriteteve të qeverisë.

Hartimi i projekttagjendës i nënshtrohet një procesi konsultimi intensiv, në bashkëpunim të ngushtë me anëtarësinë e këtij Këshilli, si dhe me palët e interesuara. Sipas rasteve, mund të përfshihen edhe ekspertë të fushave përkatëse, që do të jenë pjesë e agjendës së mbledhjes së Këshillit të Investimeve.

16. Numri i mbledhjeve të Këshillit të Investimeve të jetë, jo me pak se, gjashtë mbledhje në vit.

17. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të sigurojë zyrat, me kushtet optimale për funksionimin e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, dhe të mbulojë kostot për ujin dhe energjinë elektrike.

18. Kostot e stafit, të mobilimit të zyrave e komunikimit do të mbulohen nga donatorët.

19. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 295, datë 8.4.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 31, DATË 22.1.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN DHE MËNYRËN E
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
BREGDETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 31, datë 22.1.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “... Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit ...” zëvendësohet me “... Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ...”;

b) Pika 2, e kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e zonës bregdetare të Republikës së Shqipërisë dhe në zonat, territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.”.

c) Pika 1, e kreut II, “Organizimi i AKB-së”, ndryshohet, si më poshtë vijon;

“1. AKB-ja ka statusin e drejtorisë së përgjithshme, në nivel qendror, dhe në nivel vendor organizohet në degë rajonale.”.

ç) Pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

“KREU III/1**BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL**

1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar.

Faqe | 2578

2. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.”.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM**Nr. 296, datë 8.4.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT NGA BUXHETI I VITIT
2015 PËR BASHKËSITË FETARE
TRADICIONALE QË KANË
NËNShKRUAR MARRËVESHJE ME
KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit nga buxheti i vitit 2015, prej 109 000 000 (njëqind e nëntë milionë) lekësh, i miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, të përdoret sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 416 000 (tridhjetë e një milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, të ndarë:

i) 11 748 000 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 89 punonjës të administratës;

ii) 19 668 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, për



financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 149 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 25 872 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë:

i) 20 592 000 (njëzet milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 156 punonjës të administratës;

ii) 5 280 000 (pesë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 872 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë:

i) 5 676 000 (pesë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 43 punonjës të administratës;

ii) 20 196 000 (njëzet milionë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 153 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 25 740 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë:

i) 3 696 000 (tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 28 punonjës të administratës;

ii) 15 144 000 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë) lekë, përkatësisht:

- 10 144 000 (dhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë) lekë, për ndërtimin e Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit Botërore Bektashiane (Odeonit);

- 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për ndërtimin e Teqesë së Shtutit, Gjirokastrë.

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshit Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në

kërkesën e vitit 2015, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur për kryerjen e veprimtarive të parashtruara.

2. Kalimi i fondit të bëhet brenda muajit prill të vitit 2015.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 297, datë 8.4.2015

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT E FORMIMIT PROFESIONAL DHE TË SEKRETARIATIT TEKNIK

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, si organ këshillimor në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë. Këshilli kryesohet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe në përbërje ka anëtarë:

a) Një përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) Një përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;

c) Një përfaqësues të Ministrisë së Financave;

ç) Një përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

d) Dy përfaqësues të organizatave të punëdhënësve;



dh) Dy përfaqësues të organizatave të punë-marrësve.

2. Përcaktimi i anëtarëve të Këshillit, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d” e “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, kryhet nga institucionet përgjegjëse që marrin pjesë në këtë Këshill, me kërkesën e ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Ministri përgjegjës për çështjet sociale ka këto detyra kryesore:

a) Thërret mbledhjet dhe i drejton ato;

b) Cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, bashkërendon punën, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta;

c) Merr në konsideratë vendimet e marra gjatë mbledhjeve të Këshillit dhe orientimet programore, kur ato janë marrë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, pavarësisht nga vlerësimi i tyre individual.

4. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional ka këto funksione:

a) Këshilli mbledhet mbi bazën e një kalendari, por jo më pak se një herë në katër muaj;

b) Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjes së radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe;

c) Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime;

ç) Mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm, të paktën, gjysma e anëtarëve të Këshillit.

5. Këshilli jep mendime dhe propozime lidhur me:

a) hartimin e strategjive dhe programeve kombëtare për arsimin dhe formimin profesional, drejtimit e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve nënligjore;

b) përmirësimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me zhvillimet e sektorëve të ekonomisë dhe interesat e tregut të punës;

c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin dhe formimin profesional dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;

ç) standardet për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional;

d) zhvillimin e politikave dhe të programeve të veçanta, të kërkuara nga ministrat përgjegjës, dhe rrugët e financimit të tyre;

dh) informimin e palëve për zhvillimet aktuale dhe perspektive të sistemit të arsimit dhe formimit profesional;

e) politikat dhe strategjitë e zhvillimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional;

ë) projektligjet dhe projektvendimet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tij;

f) propozimin e grupeve të përkohshme të punës për çështje të caktuara të zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional;

g) anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional.

6. Funksionimi i Këshillit mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga dy punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).

7. Sekretariati teknik bashkërendon veprimtarinë e Këshillit dhe kryen këto detyra:

a) Organizon mbledhjet e Këshillit dhe krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre;

b) Përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e Këshillit në formën e kërkuar për ekzekutim;

c) Komunikon me kryetarin dhe me anëtarët e Këshillit në lidhje me rendin e ditës, datën, orën dhe vendin e mbledhjes së Këshillit;

ç) Shpërndan dokumentacionin e mbledhjes dhe informacione të tjera tek anëtarët e Këshillit;

d) Mban procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit;

dh) Arkivon dokumentacionin e mbledhjeve të Këshillit;

e) Lehtëson funksionimin e grupeve të përkohshme, të ngritura nga Këshilli;

ë) Hap një rubrikë të veçantë, në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të AFP-së;

f) Përgatit dhe publikon, në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, të gjitha informacionet që mund të bëhen publike, pas marrjes së miratimit nga Kryetari i Këshillit.

8. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 298, datë 8.4.2015****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 120/1, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 7, e nenit 25, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Në rastet kur pemët mbillen si elemente të trupit të rrugës, në funksion të rehabilitimit të gjelbërimit të skarpateve të rrugës, pemët mbillen në brezin e përkatësisë, jashtë bankinës, pa cenuar sinjalistikën vertikale rrugore.

Largësia nga kufiri rrugor, jashtë qendrave të banuara, që duhet respektuar nga pronarët e terreneve në kufi me pronësinë rrugore, për të mbjellë pemë anash rrugës, nuk mund të jetë më e vogël se sa lartësia më e madhe e arritshme, për secilin tip, e rritjes, deri në plotësimin e ciklit vegjetativ.”.

b) Neni 312/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 312/1**Leje drejtimi me pikë (neni 120/1 i Kodit Rrugor)**

1. Sasia e pikëve që i zbriten çdo mbajtësi lejedrejtimi mjeti, për rastet e shkeljes së normave të sjelljes, është sipas lidhjes nr. 1, “Tabela e pikëve për shkeljet e normave të sjelljes”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Mbajtësi i lejedrejtimit që ka humbur totalin e pikëve dhe mbajtësi i lejedrejtimit, i cili, pas njoftimit të shkeljes së parë, që përfshin një humbje prej, të paktën, pesë pikësh, kryen edhe dy shkelje të tjera, brenda dymbëdhjetë muajve nga data e shkeljes së parë, që kanë të bëjnë me shkurtim prej, të paktën, pesë pikësh secila, duhet t’i nënshtrohet provimit të kualifikimit teorik në Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, mbajtësit i tërhiqet lejedrejtimi nga organet e Policisë Rrugore dhe, së bashku me vendimin për heqjen e pikëve, i dërgohen Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Rifitimi i pikëve, me anë të provimit të kualifikimit teorik, është i vlefshëm pas përfundimit të kohës së pezullimit të lejedrejtimit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përgatit dhe administron procedurat e regjistrimit dhe të dhënies së provimit të kualifikimit teorik.

5. Tarifa e regjistrimit dhe e provimit të kualifikimit teorik miratohen nga ministri përgjegjës për transportin, në bazë të statutit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

6. Pyetjet e provimit të kualifikimit përzgjidhen nga kapitulli 5, “Normat e sjelljes”, të Kodit Rrugor.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përgatit strukturën dhe pyetjet e provimit të kualifikimit teorik, të cilat i publikon në faqen e saj të internetit, së bashku me përgjigjet respektive.

8. Mbajtësi i lejedrejtimit fiton provimin e kualifikimit kur përgjigjet saktë, jo më pak se, 90 për qind të sasisë së pyetjeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr. 1

Tabela e pikëve për shkeljen e normave të sjelljes
(neni 120/1 i Kodit Rrugor)

KODI RRUGOR		SASIA E PIKËVE QË DO TË HIQEN	
Neni	Pika	Për herën e parë	Për përsëritje
140	9	3 (tre)	5 (pesë)
		6 (gjashtë), për drejtues që zotëron lejedrejtimi më pak se 3 vjet	10 (dhjetë), për drejtues që zotëron lejedrejtimi më pak se 3 vjet
141	10	3 (tre)	8 (tetë)
143	2		brenda 1 viti 3 (tre)
143	3		brenda 1 viti 5 (pesë)
143	4		brenda 1 viti 5 (pesë)
143	5		brenda 1 viti 5 (pesë)
143	6		brenda 1 viti 7 (shtatë)
143	7		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
143	8		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
144	4		3 here brenda 2 vjetësh 8 (tetë)
145	1		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
145	2		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
145	3/a		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
145	3/b		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
145	3/c		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
145	3/d		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
145	4		brenda 1 viti 6 (gjashtë)
KODI RRUGOR		SASIA E PIKËVE QË DO TË HIQEN	
Neni	Pika	Për herën e parë	Për përsëritje
146	9		brenda 2 vjetësh 8 (tetë)
146	10		brenda 2 vjetësh 5 (pesë)
146	11		brenda 2 vjetësh 5 (pesë)
146	12		brenda 2 vjetësh 5 (pesë)
146	13		brenda 2 vjetësh 5 (pesë)
146	14		brenda 2 vjetësh 6 (pesë)
147	5		brenda 1 viti 8 (tetë)
148	5		brenda 1 viti 8 (tetë)
166	8	10 (dhjetë)	
170	8	3 (tre)	
174	1/a	3 (tre)	
174	1/c	8 (tetë)	
174	1/d	8 (tetë)	
175	3	10 (dhjetë)	
175	4	8 (tetë)	
177	2	3 (tre)	
184	2	8 (tetë)	brenda 1 viti 10 (dhjetë)
184	10	8 (tetë)	brenda 1 viti 10 (dhjetë)
185	1	10 (dhjetë)	brenda 1 viti 15 (pesëmbëdhjetë)
185	2	10 (dhjetë)	brenda 1 viti 15 (pesëmbëdhjetë)
187	6	8 (tetë)	
KODI RRUGOR		SASIA E PIKËVE QË DO TË HIQEN	
Neni	Pika	Për herën e parë	Për përsëritje
187	7	15 (pesëmbëdhjetë)	
190	1	10 (dhjetë)	
190	2	10 (dhjetë)	
190	4	10 (dhjetë)	
190	5	5 (pesë)	



VENDIM

Nr. 300, datë 8.4.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 468, DATË 30.5.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR
PËR ZHVILLIMIN E BROADBAND-IT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, dhe në Planin Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it, të miratuar me këtë vendim, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në tekstin e vendimit dhe në Planin Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it, emërtimi “Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” zëvendësohet me “Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike”.

2. Seksioni 1.3.5, “Iniciativa Shqipëria Digjitale” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Seksioni 1.3.5 “Strategjia Axxhenda Dixhitale 2014-2020”

“Strategjia Axxhenda Dixhitale 2014-2020”, e hartuar gjatë vitit 2014, do të zëvendësojë Strategjinë Ndërsektoriale për Shqipërinë e Informacionit, të miratuar në vitin 2009. Vizioni i kësaj strategjie është:

Një shoqëri e bazuar në dije dhe informacion për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, konsolidim të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike dhe duke rritur transparencën e qeverisjes.

Zhvillimi i infrastrukturës së përparuar të komunikimeve elektronike përcaktohet si një nga drejtëtimet kryesore të kësaj strategjie, duke e parë atë të lidhur me hapat për sigurimin e spektrit të mjaftueshëm për zhvillimet në perspektivën e infrastrukturës Broadband (NGN/LTE/5G etj),

si dhe me krijimin e kuadrit ligjor e rregullator për të drejtën e kalimit.”.

3. Teksti i seksionit 1.4 zëvendësohet me tekstin, me këtë përmbajtje:

“Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike i propozon Këshillit të Ministrave strategjitë e zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në dokumentin e politikave të komunikimeve elektronike. Detyrat e ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike përcaktohen në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 97/2013, për median audiovizive.

Organet rregullatore, AKEP dhe AMA, janë dy institucione të rëndësishme në aspektin e rregullimit të komunikimeve elektronike dhe median elektronike. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator i pavarur në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimin postar (<http://www.akep.al>), i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Kompetencat dhe detyrat e AKEP-it për komunikimet elektronike janë përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) është autoritet rregullator i pavarur i cili rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë. AMA ushtron veprimtarinë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013, “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. AMA gjithashtu administron dhe menaxhon spektrin e radiofrekuencave të caktuara për transmetime radioje dhe ato televizive, në përputhje me përcaktimet për shërbimet radiotelevizive në Planin Kombëtar të Radiofrekuencave, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Në fushën e implementimit dhe për rritjen e kërkesës për shërbime *broadband* luajnë rol të rëndësishëm dhe një numër institucionesh të tjera, si AKSHI, ASIG, ALCIRT, AKCE etj.”.

4. Në seksionin 3.1, paragrafi “Për rëndësinë strategjike që ka zhvillimi i *broadband* jo vetëm për



sektorin, por për gjithë ekonominë e vendit për udhëheqjen e procesit do të krijohet Komisioni për Zhvillimin e *Broadband* nën drejtimin e Kryeministrit” shfuqizohet.

5. Në fund të seksionit 3.2.1 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“AKEP-i, në zbatim të parashikimeve ligjore për heqjen e kufizimeve teknologjike për përdorimin e frekuencave, do të bëjë rishikimin e autorizimeve individuale të dhëna para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 102/2012. Heqja e kufizimeve teknologjike dhe ndryshimi i autorizimeve individuale përkatëse do të bëhen pa pagesë shtesë nga ana e mbajtësit të autorizimeve, duke i nxitur mbajtësit e autorizimeve, sipas një akti të nxjerrë nga AKEP-i, që të rritin mbulimin me shërbime *broadband* në zonat me densitet të ulët të popullsisë, si dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit të ofruar.

Me qëllim shmangien e interferencave të mundshme dhe të pabarazisë në treg, heqja e kufizimeve për autorizimet e dhëna para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 102/2012, për mbajtësit e autorizimeve që kanë aplikuar pranë AKEP-it për rivlerësimin e kufizimeve të bëhet e njëkohshme nëse është e mundur.

Krahas procesit të heqjes së kufizimeve teknologjike për të bërë të mundur shfrytëzimin më të mirë të spektrit të frekuencave për zhvillimin e rrjeteve *broadband*, për interes publik dhe sipas parashikimeve ligjore, nga AKEP-i do të kryhet edhe procesi i riorganizimit të spektrit në këto breza. Riorganizimi i spektrit, përmes modifikimit të autorizimeve individuale përkatëse të dhëna në brezat 900/1800 MHz, 2100 MHz, do të kryhet pas dhënies në përdorim të spektrit të lirë të mbetur në këto breza, por jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i procesit të dhënies në përdorim të këtyre brezave.

Politika spektrale e Bashkimit Evropian, e miratuar me vendimin 243/2012/EU, përcakton si detyrim të vendeve anëtare të BE-së sigurimin brenda vitit 2015 të një sasive spektri prej 1200 MHz për sistemet e avancuara IMT. Gjithashtu, studimet e ITU-së vlerësojnë që nevojat spektrale për sistemet e avancuara IMT shkojnë nga 1280 MHz në 1720 MHz. Në përputhje me politikën spektrale të Bashkimit Evropian dhe bazuar në perspektivat e zhvillimit, tendencën në rritje të trafikut të komunikimeve data si dhe zhvillimet

teknologjike, do të bëhen të gjitha përpjekjet për identifikimin dhe krijimin e sasisë së spektrit të nevojshëm për zhvillimin e rrjeteve të së ardhmes.

Qeveria do të nxitë AMA-n për ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme për lirimin e brezit të dixhital - dividentit. Ministri, në bashkëpunim me AKEP-in dhe AMA-n, do të punojnë për reflektimin e akteve finale të WRC-2015¹ në Planin Kombëtar të Frekuencave, si dhe për hartimin e ndryshimeve në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, nëse është e nevojshme.”

6. Në seksionin 3.2.1 “Periudha kohore”, përcaktimi “2012-2015” zëvendësohet me “2015-2017”.

7. Paragrafi i parë, i seksionit 5, zëvendësohet me paragrafin, me këtë përmbajtje:

“Procesi i implementimit të këtij dokumenti do të udhëhiqet në nivel vendimmarrjeje nga Komisioni për Zhvillimin e *Broadband*-it, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri, me nënkryetar ministrin përgjegjës për komunikimet elektronike, i cili duhet të ketë në përbërje ministrat e përmendur në këtë dokument. Në këtë Komision do të ftohen të marrin pjesë kryetarët e organeve rregullatore që veprojnë në fushën e komunikimeve elektronike. Komisioni do të ndjekë në vijimësi procesin e implementimit dhe arritjen e objektivave për zhvillimin e *broadbandit*.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 301, datë 8.4.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I LINJËS 400 KV, VAU I DEJËS-MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë

¹ Konferenca Boterore e Radiokomunikacionit



private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV, Vau i Dejës-Morinë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3 795 (tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) m², ndërtesë, tokë bujqësore, arë, truall dhe kullotë, vlerësuar në shumën prej 10 095 475 (dhjetë milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Fondi prej 10 095 475 (dhjetë milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh të përballohet nga fondet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të përballohet nga OST, sh.a.-ja, si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin e këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit prill 2015.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, Pukë dhe Tropojë, të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a.

8. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST, sh.a.-ja, dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 400 KV VAU DEJËS-MORINË

Qarku: Shkodër, Kukës

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Ndërtim, Tokë, Arë, Truall, Kullotë

Nr.	Numri i shtyllës	Te dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësimi m për banorë m ²	Sip. Shpronësimi për shtyllë m ²	Vlera e Shpronësimit në Lekë/m ²	Vlera e Shpronësimit në Lekë për Banorë	Vlera e Shpronësimit në Lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. Kadastrat	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip. pronës m ²						
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Komuna Vau Dejës														
Karme														
1	26	Pretendues			2097	112	Arë	10190		140	225		31500	
2	27	Pretendues			2097	154	Arë	133700		105	225		23625	
Ndërmjet 26-27		Pretendues			2097	130	Shtëpi Bani		85		28175	2394875		Pa Certifikat Pronëse
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										245				
Vlera totale në Lekë												2394875	55125	
Fshati Karme														
3	34	Pretendues			2098	3	Arë	2017		97	225		21825	
							Truall	200						
4	35	Mark	Marash	Zefi	2098	289	Arë		140	225		31500		
5	36	Gjon	Marash	Zefi	2098	289	Arë	1700		208	225		46800	
Sipërfaqja totale shpronësimi m ²										445				
Vlera totale në Lekë													100125	
Komuna Koman														
Koman														
Ndërmjet 50-51		Pretendues			2209		Shtëpi Bani		185		28175	4648875		Nuk ka informacion
Ndërmjet 50-51		Pretendues			2209		Shtëpi Bani		93		28175	2620275		Nuk ka informacion
Sipërfaqja totale ndërtimi për shpronësimi m ²									258					
Vlera totale në Lekë												7269150		
Komuna Qelez														
Fshat Bushat														
6	72	Pretendues	Pal	Vata	1330	223	Arë	1500		108	100		10800	
7	73	Pieter	Mark	Kola	1330	175	Arë	1300		133	100		13300	
8	74	Idue	Pal	Vata	1330	127	Arë	11250		133	100		13300	



Te dhena per pronesine															Shenime
Nr.	Numri I shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Lloji I pasurise	Sasia Sip prones m ²	Sip. Shpronesi m per banese m ²	Sip. Shpronesi per shtylle m ²	Vlera e Shpronesi mit ne Lek/m2	Vlera e Shpronesi mit ne Leke per Banese	Vlera e Shpronesi mit ne Leke per shtylle		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	
9	75	Pretendues			1330	336	Are	3125		87	100		8700		
					Siperfaqja totale shpronesi m2					461			46100		
					Viera totale ne Leke										
Komuna Iballë															
Fshati Berishe Vendi															
10	86	Pretendues			1163	322	Are	796		105	100		10500		
					Siperfaqja totale shpronesi m ²					105			10500		
					Viera totale ne Leke										
Fshati Berishe e Vogel															
11	89	Pretendues			1162	493	Are	4236		140	100		14000		
12	90	Pretendues			1162	355	Are	120		97	100		9700		
13	91	Pretendues			1162	244	Are	832		133	100		13300		
14	92	Pretendues			1162	244	Are	832		118	100		11800		
					Siperfaqja totale shpronesi m2					488			48800		
					Viera totale ne Leke										
Fshat Shopel															
15	96	Prendush	Frrok	Kola	3402	146	Are	2503		133	100		13300		
					Siperfaqja totale shpronesi m ²					133			13300		
					Viera totale ne Leke										
Fshati Berishe e Sipërme															
16	106	Pretendues			1160	861	Are	7768		117	100		11700		
17	107	Pretendues			1160	861	Are	7768		133	100		13300		
18	111	Pretendues			1160	199	Are	289		150	100		15000		
19	112	Pretendues			1160	19	Are	1556		165	100		16500		
					Siperfaqja totale shpronesi m2					565			56500		
					Viera totale ne Leke										
Komuna Bugjon															
Fshat Bugjon															
20	117	Pretendues			1300	917	Are	12331		140	100		14000		
21	118	Pretendues			1300	827	Are	5499		117	100		11700		
22	119	Gjelo	Stak	Sheqer	1300	703	Are	2503		117	100		11700		
23	120	Mark	Mic	Sokoll	1300	612	Are	1613		149	100		14900		
24	121	Gjin	Lek	Pjetri	1300	349	Are	707		149	100		14900		
					Siperfaqja totale shpronesi m2					672			67200		
					Viera totale ne Leke										
Shënime															
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	
25	128	Pretendues			1619	526	Are	972		118	100		11800		
26	129	Pretendues			1619	372	Are	1446		87	100		8700		
27	130		Nik	Bala	1619	131	Are	3931		133	100		13300		
					Siperfaqja totale shpronesi m ²					338			33800		
					Viera totale ne Leke								33800		
												9664025	431450		
Siperfaqja total. shpronesi per shtylla 3452 m2 me viera totale ne leke 431 450												Shuma Totale		10095475	
Siperfaqja total. shpronesi per ndertim 343 m2 me viera totale ne leke 9 664 025															

VENDIM

Nr. 302, datë 8.4.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË, LOTET 6-11 (OBJEKTE DHE TOKA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, lotet 6-11(objekte dhe toka)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 126 660 438 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e tetë) lekësh, nga të cilat:

a) Tokë “truall”, me sipërfaqe 1 161 (një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) m², me vlerë 2



594 752 (dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë;

b) Objekte, me vlerë 124 065 686 (njëqind e njëzet e katër milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “truall” dhe “objekte”, prej 126 660 438 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, (zëri “Shpronësime”), planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët janë bërë shënimet “Konfirmim ZVRPP”, “Certifikatë pronësie” e “Leje ndërtimi”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të

Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kavajë e Rrogozhinë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kavajë e Rrogozhinë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kavajë e Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

OBJEKTET DHE TOKAT QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT “PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË” LOTI 6-11 (OBJEKTET DHE TOKAT TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I RRUGËS KRYESORE+ RRUGA DYTËSORE)

Nr	Pronari			Z.K.	Nr. Pas.	EMËRTIMI I OBJEKTEVE	OBJEKTE (M ²)	TRUALL			VLERA TOTALE (LEKE)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					SIP. (M ²)	ÇMIMI (LEK/M ²)	VLERA		
1	Ilmi		Parllaku	3204	68/116	Shesh, sistemime, loti 6					380,058	Certifikatë pronësie
2	Isa		Veza	3204	68/38	Shesh, sistemime, loti 6					448,487	Leje ndërtimi
3	Dritan		Kanapari	8551	5/192	Shesh, sistemime, loti 6					273,576	Leje ndërtimi
4	Shaban		Tatani	3204	68/14	Lokal 1kt loti 6	68.5				1,327,090	Certifikatë pronësie
5	Izet	Rustem	Tatani	3204	169/21	Banesë 2kt loti 6	321.4				8,493,720	Certifikatë pronësie
6	Nuredin	Halit	Daiu	3554	308/21	Banesë 2kt loti 6	274.2				5,831,298	Certifikatë pronësie
7	Mirazh		Shkodra	8551	5/387	Shesh, sistemime, loti 6					415,091	Leje ndërtimi
8	Ymer		Xhabysa	3554	310/33	Shesh, sistemime, loti 6					529,577	Leje ndërtimi
9	Ndriçim	Shyqyri	Xhiani	8551	5/273	Shesh, sistemime, loti 6					1,303,910	Certifikatë pronësie
10	Jovan	Spiro	Simaku	8551	5/193	Shesh, sistemime, loti 6					762,522	Certifikatë pronësie
11	Lutfi		Xhafa	3204	67/11	Shesh, sistemime, loti 6					444,378	Leje ndërtimi
12	Gezim		Hyskaj	3204	68/94	Shesh, sistemime, loti 6					430,635	Leje ndërtimi
13	Bashkim		Shehi	3204	68/88, 68/83	Shesh, sistemime, loti 6					1,157,581	Leje ndërtimi
14	Hamdi		Rroshi	8551	5/353	Shesh, sistemime, loti 6					1,270,339	Certifikatë pronësie
15	B.p. Bajaziti			8551	5/110	Shesh, sistemime, loti 6					756,150	Leje ndërtimi
16	Artan	Kozma	Shyti	8552	12/299	Karburant "Kastrati"(pjesërisht), loti 7					1,396,542	Konfirmim ZVRPP
17	Mirazh		Shkodra	8552	18/362	Karburant "Alpet"(pjesërisht), loti 7					1,585,681	Konfirmim ZVRPP
18	Mirazh		Shkodra	8552	18/441	Karburant "Alpet"(pjesërisht), loti 7					4,162,875	Certifikatë pronësie
19	Zyber		Culhaj	8552	1/153	Banesë 1kt, loti 7	434.0				3,717,743	Certifikatë pronësie
20	Rustem Suzana		Kaja Kaja	8552	10/63,	Banesë 1kt, loti 7	117.0				4,095,089	Konfirmim ZVRPP
21	Aleksander Marieta		Proda Proda	8552	12/315	Banesë 2kt, loti 7	286.0				3,060,589	Konfirmim ZVRPP
22	Qani		Hoxha	8552	12/253	Banesë 1kt, loti 7	134.0				4,007,376	Konfirmim ZVRPP
23	Idriz		Kollcaku	8552	10/61,	Shesh, sistemime, loti 7					369,716	Konfirmim ZVRPP
24	Jakup		Kollcaku	8552	10/62,	Shesh, sistemime, loti 7					282,505	Konfirmim ZVRPP
25	Avni		Lila	8552	12/311	Shesh, sistemime, loti 7					974,128	Konfirmim ZVRPP
26	Blendi Gentian		Duhanxhi Lila	8552	12/44,	Shesh, sistemime, loti 7					1,025,236	Certifikatë pronësie
27	Ylli Lavdi Mynyr		Bekshiu Bekshiu Bekshiu	8552	12/336	Shesh, sistemime, loti 7					1,164,569	Konfirmim ZVRPP
28	Hamdi		Myfiu	8552	18/425	Shesh, sistemime, loti 7					997,652	Certifikatë pronësie
29	Vullnet Fatos		Demrozi Demrozi	8552	18/6	Shesh, sistemime, loti 7					454,632	Certifikatë pronësie



30	Jani	Kristo	Papa	8552	12/287	Ndërtësë 1 kt, loti 7	115.6				4,251,851	Certifikatë pronësie
31	Murat	Haqim	Çelhaka	3818	18/102	Shesh, investime, loti 8					3,004,501	Certifikatë pronësie
32	Vullnet	Ramiz	Dedja	3817	18/110	Shesh, investime, loti 8					2,504,191	Certifikatë pronësie
33	Bardhyl	Riza	Tola	3817	14/34	Shesh, investime, loti 8					2,198,898	Certifikatë pronësie
34	Bardhyl	Riza	Tola	3817	15/25	Shesh, investime, loti 8					1,061,930	Certifikatë pronësie
35	Bardhyl	Riza	Tola	3817	14/39	Shesh, investime, loti 8					817,546	Certifikatë pronësie
36	Rozeta		Baha	3817	18/64	Karburant loti 8					7,285,157	Certifikatë pronësie
37	Mirjan		Hoxha	3817	17/184	Shesh, investime, loti 8					1,223,476	Certifikatë pronësie
38	Figiri		Hoxha	3817	17/273	Shesh, investime, loti 8					1,101,066	Certifikatë pronësie
39	Pellumb		Ninga	3817	15/165	Shesh, investime, loti 8					620,315	Certifikatë pronësie
40	Kujtim		Kurti	3817	15/21	Shesh, investime, loti 8					438,513	Certifikatë pronësie
41	Mendrin	Mehdi	Dervishi	3817	17/245	Shesh, investime, loti 8					1,084,746	Certifikatë pronësie
42	Agim		Dogjani	3427	26/7	Karburant "Eurodrin" (pjesërisht), loti 8 majtas					4,398,326	Konfirmim ZVRPP
43	Shoqëria "Eurodrin" sha Shyqyri		Duraku	3427	7\17, 7\18	Karburant "Eurodrin" (pjesërisht) Loti 8 djathtas					4,021,021	Konfirmim ZVRPP
44	Mersin	Hysen	Sinameta	3427	46/40	Karburant, loti 8	68.0				7,735,417	Konfirmim ZVRPP
45	Nazmi	Sali	Çepeli	3427	46/34	Shesh, investime, loti 8					487,155	Leje ndërtimi
46	Durim	Sali	Çepeli	3427	46/30	Shesh, investime, loti 8					459,900	Leje ndërtimi
47	Genci	Sali	Çepeli	3427	46/33	Shesh, investime, loti 8					499,846	Leje ndërtimi
48	Fatmir	Qemal	Bego	3817	100/19	Shesh, investime, loti 8					290,418	Certifikatë pronësie
49	Durim	Qemal	Bego	3817	100/18	Shesh, investime, loti 8					290,418	Certifikatë pronësie
50	Firma "Biba"			3427	8/2,8/3	Shesh, investime, loti 9					1,070,382	Leje ndërtimi
51	Mehmet		Beu	1932	157/2	Shesh, investime, loti 9					698,532	Leje ndërtimi
52	Vellezerit Ajdini			3427	13/9	Shesh, investime, loti 9					785,328	Certifikatë pronësie
53	Ibrahim		Mustafa	3427	27/4	Shesh, investime, loti 9					167,720	Leje ndërtimi
54	Esat		Beu	2399	133/17	Karburant "Taci" pjesërisht, loti 9					1,100,690	Leje ndërtimi
55	Zylyf		Haremi	2399	71/26	Shesh, investime, loti 9					1,512,452	Certifikatë pronësie
56	Llazar	Sotir	Angjeli	3235	259/38	Karburant "Anoil" djathtas (pjesërisht), loti 11					8,513,231	Konfirmim ZVRPP
57	Gugash		Magani	3235	259/54	Karburant "Anoil" majtas (pjesërisht), loti 11					3,980,986	Leje ndërtimi
58	Sami, Ramazan & Arif Daja			3235	259/50	Shesh, investime, loti 11					1,932,470	Leje ndërtimi
59	Eqerem		Deliu	3235	245/10	Karburant "API", loti 11					7,685,798	Konfirmim ZVRPP
60	Maliq	Hajrullah	Kullolli	3235	259/26	Shesh, investime, loti 11					390,879	Leje ndërtimi
61	Rrahman	Abdyl	Hyka	1815	245/7	Shesh, investime, loti 11					300,896	Leje ndërtimi
62	Ruzhdi	Hajdar	Proshka	1815	261/54	Shesh, investime, loti 11					1,032,886	Konfirmim ZVRPP
63	Bashkëpronarët		Bekshiu	8552	12/336	Loti 7 (tokë)		140	14800	2072000	2,072,000	Certifikatë pronësie(sip. shitesë)
64	Behar	Reshat	Saraçi	1814	210/2	Loti 10 (tokë)		285	512	145920	145,920	Certifikatë pronësie
65	Nuri	Shefqet	Saraçi	1814	210/3	Loti 10 (tokë)		266	512	136192	136,192	Certifikatë pronësie
66	Ejup	Shefqet	Saraçi	1814	210/4	Loti 11 (tokë)		470	512	240640	240,640	Certifikatë pronësie
			TOTALI					1,161.0		2,594,752.0	126,660,438	

**VENDIM****Nr. 303, datë 8.4.2015****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT “NYJA RRUGORE VORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Nyja rrugore Vorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “arë”, “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 9 220 470 (nëntë milionë e dyqind e njëzet mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekësh, nga të cilat:

a) për sipërfaqen 5 849 (pesë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) m², tokë “arë” dhe “truall”, me vlerë 4 386 787 (katër milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë;

b) për objekte, me vlerë 4 833 683 (katër milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekte”, prej 9 220 470 (nëntë milionë e dyqind e njëzet mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, i miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.


9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë